



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 44 datë 26.10.2023**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 71 , DATË 27.12.2022 “PËR MIRATIMIN E  
BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM  
PËRFUNDIMTAR 2023-2025 TË BASHKISË SHKODËR“TE NDRYSHUAR**

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot në datë 26.10.2023, në mbështetje të neneve 40, 41, 54 germa ‘dh’, 55 pika 3 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ,të nenit 45 te ligjit nr.68/2017` Për financat vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar,,” Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; Udhëzimi Plotësues nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023 i ndryshuar , VKB nr. 71 , datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar, dhe sipas materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e fondeve për objektin **“Blerje materiale per përmirësimin e sinjalistikes dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen më bicikleta (vazhdim) me vlerë 10,500,000 lekë, sipas fishës bashkëlidhur**
2. Burimi i financimit të jetë fondet e trashëguara në programin 05100 “Menaxhimi i mbetjeve”, zëri shpenzime operative (Art.602), kapitulli 5.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**KRYETAR**

\_\_\_\_\_  
**Oltion LULI**



**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

\_\_\_\_\_

**Denis Lesha**

Miratuar me 43 vota

Vota Pro 43

Vota Kunder 0


Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.10.2023

Nr.1	P04570.Q1.O1.A1“Blerje materiale për përmirësimin e sinjalistikes dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen më bicikleta” (vazhdim)	Funksioni 4 Cështje ekonomike Lloji i programit : 04750 Transporti publik
<p>a) <b>Pershkrimi i shkurter i projektit</b> : Shkodra është qyteti i biçikletave ku përdorues të biçikletës janë jo vetëm të rinjtë por edhe të moshuarit. Biçikleta përbën një nga mjetet më të rëndësishme të transportit. Për vetë rëndësinë që paraqet ky mjet transporti , Plani i Përgjithshëm Vendor i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit me nr 5 datë 16.09.2017 , pika 3.8.5 Rjeti i biçikletave përcakton llojet e moduleve të këtyre rrugëve si edhe këkresën më rritjen e sigurisë së tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 8 segmente të përshtatura me modulën_B</li> </ul> <p>Moduli_B</p> <p>Në këtë modul korsitë e biçikletave janë të integruara me hapësirën e automjeteve. Dy hapësirat ndahen me sinjalistikë horizontale dhe kanë një system ndarës të tillë që lejojnë lidhjen midis tyre. Ky modul përshtatet Brenda qytetit të Shkodrës.</p>		
<p><b>i. Situata</b></p>		
<p>Rjeti ekzistues i korsisë së biçikletave është rreth 23 km.Bazuar në studimet e kryera rreth 29% e popullsisë së qytetit të Shkodrës përdor bicikletat.</p> <p>Në zbatim të vendimit Nr.31 datë 13.09.2023 “Për një ndryshim në VKB nr. 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër” i ndryshuar, është realizuar përmirësimi i sinjalistikës për rritjen e sigurisë për lëvizjen me bicikleta në aksin kryesor Bulevardi “Marin Becikemi”-“ Edit’ h Durham”- “Mehmet Pashë Plaku “- “Mbreti Gent” me gjatësi 3 km. Realizimi i këtij projekti ka rezultuar i suksesshëm pasi ka rritur sigurinë për përdoruesit e biçikletave, shkurtimin e kohës së lëvizjes si dhe uljen e rrezikshmërisë në korsitë e lëvizjes së automjeteve.</p> <p>Duke parë efektshmërinë e realizimit të këtij projekti, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe për të rritur sigurinë për përdoruesit e biçikletave, bashkia propozon vazhdimin e projektit për përmirësimin e infrastrukturës për rritjen e sigurisë për qytetarët që lëvizin me bicikleta. Ky projekt propozojmë të vijojë fillimisht në “Unazën Perëndimore” dhe më pas në rrugë të tjera me synimin për të krijuar një rrjet funksional për lëvizjen me bicikleta.</p> <p>Projekti parashikon vijëzimin e korsisë së biçikletave duke vendosur sinjalistikën vertikale dhe horizontale të saj , njëkohësisht do të vendosen “ dissuasorët “ apo kufizuesit e rrugës të cilët rritin sigurinë e përdoruesve të rrugës në masën 93% kjo referuar studimeve europiane. Shpenzimet parashikohen vetëm për bazën materiale ndërsa punimet do të realizohen nga punonjësit e shërbimeve të Bashkisë.</p>		

459420 131  
4605228 270

459199 121  
4605228 270



459420 131  
4605228 270

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna  
gjeohapësimore të ofruara nga autoritetet publike  
përgjegjëse.  
Përgjegësia për saktësinë e të dhënave është e  
autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 100 200 400 m

Sistemi koordinativ: KRGJSH  
Projektimi: KRGJSH

459199 121  
4605228 270

## ii. Synimi i projektit




Projekti synon në përmirësimin e rrjetit ekzistues të bicikletave në një gjatësi prej 6 000 m duke e rritur sigurinë rugore të tij.

Ndërhyrja për rritjen e sigurisë do të bëjë lidhjen e rrjetit me rrjetin ekzistues me “Unazën Perëndimore” me gjatësi të përgjithshme 3.1 km dhe më pas në rrugë të tjera me synimin për të krijuar një rrjet funksional për lëvizjen me bicikleta.

Kërkojmë të kryejmë këtë ndërhyrje shoqëruar vijëzimin e korsisë së bicikletave duke vendosur sinjalistikën vertikale dhe horizontale të saj, njëkohësisht do të vendosen “dissuasorët” apo kufizuesit e rrugës të cilët rritin sigurinë e përdoruesve të rrugës në masën 93% kjo referuar studimeve europiane.

### Le auto sono i dissuasori migliori?

Se le auto parcheggiano a sinistra della pista ciclabile e ci sono ulteriori dissuasori, è molto sicuro per la maggior parte.



### iii. Aktivitetet kryesore të projektit

-Përgatitja e procedurës me objekt: “Blerje materiale për përmirësimin e sinjalistikës dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen me bicikleta” (vazhdim)

- Realizimi i Sinjalistikës Horizontale
- Realizimi i Sinjalistikës Vertikale.



Figura II.92/a, nen 120

RRUGEKALIMI PËR BIÇIKLETA, NGJITUR ME TROTUARIN  
Tregon fillimin ose vazhdimin e një piste ose korsie, të rezervuar për biçikleta, ngjitur ose paralel me një trotuar ose edhe me një kalim të rezervuar për këmbeasore. Simbolet mund të jenë të anasjelltë, për të treguar pozicionin real të pistës e të trotuarit.

<b>b) Rezultatet që prisni</b>					
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërhyrja do të rritë sigurinë e përdoruesve të bicikletave</li> <li>• Përmirësohet qarkullimi në përgjithësi në qytet</li> <li>• Ulet ndotja mjedisore, pakësim i PM që gjenerohet nga makinat.</li> <li>• Zvogëlim i CO2.</li> </ul>					
<b>c) Aktoret e mundshëm</b>			<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>		
Bashkia Shkodër Banoret e Bashkisë Shkoder			Bashkia Shkodër		
<b>e) Shpenzimet e llogaritura ( per cdo aktivitet te mesiperme (pika iii)</b>					
<b>Shpenzimet per cdo aktivitet 2023</b>		<b>Totali (000 lek)</b>	<b>Nga kjo:</b>		
			<b>Paga, sig</b>	<b>operative</b>	<b>kapitale</b>
A1	Blerje materiale per përmirësimin e sinjalistikes dhe rritjen e sigurisë për lëvizjen më biciklela (vazhdim)	10,500		10,500	
	<b>Shuma</b>	<b>10,500</b>		<b>10,500</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit(kur fillon, kur perfundon)</b> Nëntor 2023- Dhjetor 2023		<b>g) Pergatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtorja e Shërbime Publike dhe Ndjekjes së investimeve në infrastrukturë  <b>Institucion Likuidues: Bashkia Shkoder</b>			

